



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019 , Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.07.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE KOMPANISË RAJONALE TË
MBETURINAVE "PASTRIMI"SH.A

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej **25,000.00 €** (njëzet e pesë mijë) euro, për subvencionimin e familjeve në asistencë sociale të Komunës së Lipjanit për pagesën e borgjeve përkatësisht kryerjen e pjesërishme të obligimeve të grumbullura deri me datën 31.10.2022, që familjet në asistencë sociale kanë ndaj KRM "Pastrimi" për ofrimin e shërbimeve për marjen e mbeturinave .

II. Obligohet KRM "Pastrimi" që më së largu brenda afatit 45 (katërdhjetë e pesë) ditësh nga dita e ekzekutimit të pagesës të sjellë Raport financiar për Kryetarin e Komunës duke i bashkëngjitur regjistrin e familjeve të subvencionuara.

III. Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale mban përgjegjësinë për hartimin e regjistrit të familjeve në asistencë sociale në koordinim me Qendrën për Punë Sociale në Lipjan.

IV. Mjetet financiare për ekzekutimin e këtij Vendimi do të ndahen nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2023 , fondi burimor :21/613/16003/200/00000/0111 në xhirollogarinë bankare të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave " Pastrimi"SH.A.

V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

VI. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

Nr. 15-400/01-39095

Lipjan, më 28.07.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

